

V E N D I M

Nr. 170, date 25.4.2002

PER PERCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TE KUSHTEVE PER DHENIEN E LEJEVE E TE AUTORIZIMEVE PER TREGTIMIN E NAFTES, GAZIT E NENPRODUKTEVE TE TYRE

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te neneve 19, 20 e 21 te ligjit nr. 8450, date 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve te tyre", me propozimin e Ministrit te Industrisë dhe Energjetikes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

I. Procedura e dhënies se lejeve te tregtimit

Shoqëritë qe ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumice te naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve te tyre pajisen me lejen e tregtimit nga ministri qe mbulon veprimtarinë hidrokarbure.

- a) Leje e llojit " A ", qe u jepet shoqërive për tregtimin e naftës e te nënprodukteve te saj, me përjashtim te nënprodukteve te përcaktuara për përdorim nga mjetet e fluturimit ajror.
- b) Leje e llojit "B", qe u jepet shoqërive për tregtimin e gazit te lëngshëm te naftës dhe mbushjen e bombolave me këtë nënprodukt.
- c) Leje e llojit "C", qe u jepet shoqërive për tregtimin e nënprodukteve te naftës për mjetet e fluturimit ajror.

Dhënia e lejeve te tregtimit behet ne baze te procedurave te mëposhtme:

1. Subjekti paraqet pranë strukturës përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet kërkesën për marrjen e lejes se tregtimit, te përcaktuar për kategorinë e produkteve, qe do te tregtoje.
2. Dokumentet qe duhet te shoqërojnë kërkesën janë:
 - a) vendimi i gjykatës për regjistrimin e personit juridik;
 - b) certifikata e regjistrimit ne zyrën e tatimeve dhe dokumenti i NIPT- it;
 - c) vërtetimi i pronësisë ose kontrata e qerese për depozitat qe do te përdorë subjekti;
 - ç) projekti teknologjik i depove dhe i linjave, i miratuar nga organet e qeverisjes vendore te mbrojtjes nga zjarri dhe te mjedisit; për lejet e llojit " A " kategoria IV /a, projekti teknik i magazinës se vajrave. Për lejet e llojit "B" projekti teknologjik i depove dhe i linjave duhet te jete i miratuar edhe nga organet përkatëse te kontrollit te pajisjeve nen presion
 - d) leja e shfrytëzimit, e lëshuar nga zyra e urbanistikës.;
 - dh) vërtetimi për kontrollin e objektit për respektimin e kushteve teknike, i lëshuar nga Inspektorati Qendror Teknik.
 - e) certifikata e matjes se vëllimit te depove nga organet përkatëse te kalibrimit dhe metrologjisë, ne njësitë e qeverisjes vendore; përjashtohen nga kjo kërkesë subjektet qe kërkojnë te pajisen me leje te llojit "A" , kategoria IV /a (vajra lubrifikante).
 - f) Leja mjedisore, sipas legjislacionit ne fuqi për mjedisin.
 - ë) vërtetimi i pronësisë ose kontrata e marrjes ne përdorim e mjeteve te transportit për naftën, gazin dhe nënproduktet e saj .

3. Struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet ushtron kontroll për vërtetësinë e te dhënave dhe te treguesve të paraqitur në dokumentacionin e subjektit kërkuar.
4. Kur nga vërtetimi i te dhënave dhe treguesve rezulton se janë plotësuar kushtet e kërkuara, ministri jep lejen e tregimit të veçante, sipas kategorive përkatëse të produktit që do të tregohet.
5. Afati për ushtrimin e kontrollit dhe afati i dhënies së lejes nuk mund të jete më shumë se 30 dite nga data e mbërritjes së kërkesës së subjektit në ministri.
6. Kur nga vërtetimi i te dhënave dhe treguesve rezulton se nuk plotësohen kushtet e kërkuar, dokumentet e paraqitura i kthehen subjektit, i cili mund t'i riparqese pas plotësimit.
7. Kur, pas afatit prej 30 ditësh nga çasti i depozitimit të kërkesës, subjektit nuk i është kthyer përgjigje, ai ka të drejte të ankohet në përputhje me procedurat administrative.

II. Procedura për dhënien e autorizimeve

Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjetet dhe vajrave lubrifikante bëhet nga:

- a) ministri, që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni do të ndërtohet në autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve;
- b) organet e qeverisjes vendore, kur stacioni do të ndërtohet në rrugë urbane kryesore, rrugë urbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është organi i qeverisjes vendore.

Procedurat për dhënien e së drejtës për ndërtimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjete dhe vajrave lubrifikante, në zonat e shërbimit në rrugët e reja, kombëtare e vendore, kryhen sipas rasteve, nëpërmjet konkurrimit, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Këto procedura realizohen nga ministria përgjegjëse për transportin, kur stacionet do të ndërtohen në autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe nga organet e qeverisjes vendore, kur stacioni do të ndërtohet në rrugë urbane kryesore, rrugë urbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është organi i qeverisjes vendore.

1. Për marrjen e autorizimeve për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajrave lubrifikante, subjekti duhet të paraqesë pranë organit që ka të drejtën e dhënies së autorizimit këto dokumente:

- a) vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik;
- b) certifikatën e regjistrimit në zyrën e tatimeve;
- c) projektin teknologjik të depove dhe linjave, të miratuar nga organet e qeverisjes vendore të mbrojtjes nga zjarri dhe të mjedisit;
- ç) aktin e kontrollit dhe lejen e shfrytëzimit, të lëshuar nga zyra e urbanistikës;
- d) vërtetimi për kontrollin e objektit për respektimin e kushteve teknike të lëshuar nga Inspektorati Qendror Teknik;
- dh) certifikatën e kalibrimit të rezervuarëve, të vendosur në stacion dhe të matjes së aparateve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe stacionet e mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm, të lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit në njësitë e qeverisjes vendore. Projekti teknologjik për depot dhe linjat që përdoren për depozitimin dhe shitjen e gazit të lëngshëm të naftës, duhet të jete i miratuar nga Inspektorati Qendror Teknik.
- e) Autorizimin për hyrje-dalje në rrugë, të lëshuar nga:

i) Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, kur stacioni do të ndërtohet në autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është po Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve;

ii) organet e qeverisjes vendore, kur stacioni do të ndërtohet në rrugë urbane kryesore, rrugë urbane dytësore dhe rrugë vendore, ku ent pronar është vetë organi i qeverisjes vendore.

2. Organet, qe kane përgjegjësi për dhënien e autorizimeve, ushtrojnë kontroll për te dhënat dhe treguesit e paraqitur ne dokumentacionin e subjektit kërkues.

3. Kur pas vërtetimit, te dhënat dhe treguesit e paraqitur ne dokumentacion plotësojnë kushtet e kërkuara, organi përkatës jep autorizimin për ushtrimin e veprimtarisë ne stacionin e shitjes se karburanteve, gazit te lëngshëm. Afati për kontrollin e dokumentacionit dhe plotësimin e autorizimeve nuk mund te jete me i madh se 15 dite nga dita e mbërritjes se kërkesës ne organin qe ka detyre dhënien e autorizimit.

4. Kur, pas vërtetimit, te dhënat dhe treguesit nuk plotësojnë kërkesat, dokumentet e paraqitura i kthehen subjektit dhe afati i mësipërm fillon me riparqitjen e tyre.

5. Kur, pas afatit prej 15 ditësh nga çasti i paraqitjes se kërkesës, subjektit nuk i është kthyer përgjigje, ai ka te drejte te ankohet sipas procedurave administrative.

6. Dhënia e autorizimeve për njësitë e shitjes se lendeve djegëse dhe bombolave te gazit te lëngshëm te naftës, qe ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit për përdorim rezidencial behet nga organet e qeverisjes vendore.

Subjekti, qe kërkon te pajiset me autorizimin për shitjen e lendeve djegëse dhe te bombolave te gazit te lëngshëm te naftës, duhet te paraqesë këto dokumente:

a) Vërtetimin për pronësinë apo kontratën e marrjes ne përdorim te mjedisit përkatës;

b) Certifikatën e kalibrimit te enëve dhe te aparateve te shitjes, te lëshuar nga organet e metrologjisë e te kalibrimit ne njësitë e qeverisjes vendore;

e) Vërtetimin e lëshuar nga Inspektorati Qendror Teknik, për respektimin e kushteve dhe te rregullave teknike për njësitë e shitjes se lendeve djegëse dhe te bombolave te gazit te lëngshëm te naftës.

Kur njësitë e shitjes se lendes djegëse tregtojnë bombola gazi te lëngshme te naftës, duhet te paraqesin edhe vërtetimin nga Inspektorati Qendror Teknik.

7. Afati për vërtetimet e nevojshme dhe plotësimin e autorizimeve për njësitë e shitjes se lendeve djegëse nuk mund te jete me i madh se 10 dite nga data e mbërritjes se kërkesës.

8. Kur nga vërtetimet rezulton se nuk janë plotësuar kushtet e caktuara, dokumentet i kthehen subjektit dhe afati i mësipërm fillon me riparqitjen e tyre.

9. Kur, pas afatit prej 10 ditësh nga çasti i paraqitjes se kërkesës, subjektit nuk i është kthyer përgjigje, ai ka te drejte te ankohet sipas procedurave administrative.

III. Pagesat

Dhënia e lejeve te tregtimit dhe te autorizimeve behet kundrejt pagesës nga subjekti kërkues.

Tarifat e pagesës për lejet dhe autorizimet, qe jepen për here te pare, janë:

1. për lejet e tregtimit te llojit " A " 500 000 leke

2. për lejet e tregtimit te llojit "B" 200 000 leke

3. për lejet e tregtimit te llojit "C" 200000 leke

4. Për autorizimet për stacionet e shitjes se karburanteve, gazit te lëngshëm te naftës për automjete dhe vajrave lubrifikante 100 000 leke

5. Për autorizimet për njësitë e shitjes se lendeve djegëse dhe bombolave te gazit te lëngshëm te naftës 50 000 leke.

Tarifat për përsëritjen periodike te lejeve te tregtimeve dhe te autorizimeve janë sa gjysma e tarifave te mësipërme.

Te ardhurat, qe realizohen nga pagesat e tarifave për pikat 1, 2 dhe 3 te përdoren ne masën 90 për qind nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet, për financimin e veprimtarisë se strukturave te kësaj ministrie, për investime, ndjekje dhe monitorim te tregut te naftës, gazit dhe nënprodukteve te tyre, kualifikimin profesional dhe për përpunimin e botimin e te dhënave për kete treg.

Te ardhurat, qe realizohen nga pagesat e tarifave për pikat 4 dhe 5 te kreut III, te përdoren nga organi i pushtetit vendor qe i jep autorizimin, ne përputhje me kërkesat e legjislacionit ne fuqi.

10 për qind e te ardhurave te përfituara nga gjobat e vendosura nga strukturat e ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet ne zbatim te nenit 13 te ligjit nr.9218, date 8.4.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8450, date 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve te tyre", me miratimin e ministrit, te përdoren vetëm për blerje te pajisjeve dhe te aparaturave, për rritjen cilësore te punës ne këtë sektor, si dhe për publikime, kualifikime e specializime brenda dhe jashtë vendit.

IV. Kushtet për pajisjen me leje tregtimi

1. Kapitali minimal i kërkuar është kapitali themeltar i shoqërisë anonime. Kushtet dhe rregullat teknike për përpunimin e bombolave te gazit te lëngshëm te naftës, ne njësitë e tregtimit me pakice te tyre, përgatiten nga organizmat dhe institucionet ne përbërje ose varësi te ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet dhe miratohen nga ministri qe mbulon veprimtarinë hidrokarbure.

2. Kapaciteti më i vogël i depozitave të shoqërive, që kërkojnë të pajisen me leje tregtimi, sipas llojit të lejes, është:

a) Për lejet e tregtimit të llojit "A", jo më pak se 3 000 (tre mijë) m³ dhe kur kjo leje jepet për disa kategori produktesh, depozitat, për secilën kategori duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra.

b) Për lejet e tregtimit të llojit "A", kategoria IV/a, kapaciteti magazinues i mbuluar të jetë, me sipërfaqe jo më të vogël se 100 (një qind) m².

c) Për lejet e tregtimit të llojit "B", impiantet e depozitimit të gazit të lëngëzuar të jenë me kapacitet të instaluar, jo më pak se 500 (pesë qind) m³.

ç) Për lejet e tregtimit të llojit "C", kur:

i) leja jepet për produkte të kategorisë II/b, jo më pak se 500 (pesë qind) m³.

ii) leja jepet për produkte të kategorisë III/c, jo më pak se 1 000 (një mijë) m³.

Bëjnë përjashtim nga kushti i plotësimit të kapacitetit më të vogël, sipas kësaj pike, shoqëritë anonime, që kanë marrëdhënie kontraktore, sipas dispozitave ligjore në fuqi, për depozitat e karburanteve në portin e Durrësit. Kushti i kapacitetit më të vogël të depozitave dhe i vendosjes në to të mjeteve matëse dhe të kalibrimit të tyre duhet të plotësohet, brenda 18 muajve pas fillimit të zbatimit të masterplanit, në territorin e depozitave të karburanteve në portin e Durrësit.

Shoqëritë e pajisura aktualisht me "Leje tregtimi", brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të plotësojnë kushtin e kapacitetit minimal, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

3. Shoqëritë anonime, qe kërkojnë te marrin lejen e tregtimit, duhet te kenë ne pronësi ose ne përdorim, ne çastin e kërkesës për leje dhe gjate gjithë kohës se veprimtarisë, një mjet transporti për naftë, gaz apo nënprodukte te tyre.

4. Depozitat e subjekteve, qe kërkojnë te pajisen me leje te llojit "A", "B" dhe "C", (përjashtim bëjnë lejet e llojit " A ", kategoria IV /a (vajra lubrifikante), duhet te jene te kalibruara nga organet përkatëse te metrologjisë e te kalibrimit ne njësitë e qeverisjes vendore.

5. Lejet e tregtimit duhet te përmbajnë:

a) numrin e lejes dhe datën e lëshimit te saj;

b) emrin dhe selinë e subjektit qe merr lejen;

c) llojin e lejes dhe kategorinë e produktit që do të tregtohet;

ç) afatin e vlefshmërisë së lejes;

d) vendndodhjen e depozitave ose të magazinës;

dh) llojin dhe afatin e dokumentacionit, që duhet të dërgojnë në ministri.

6. Te dhënat e përcaktuara në shkronjat a, b, c, ç, d të pikës 7 të këtij vendimi janë të vlefshme dhe për autorizimet.

7. Shoqëritë e pajisura me leje tregtimi ose autorizim, brenda 30 ditëve nga data e pajisjes, duhet të kryejnë sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t'u shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë.

Shoqëritë, që kanë kryer sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t'u shkaktojnë palëve të treta, sipas përcaktimit të shkronjës "a", duhet që brenda këtij afati, të paraqesin dokumentin përkatës në organin, që ka lëshuar lejen e tregtimit ose autorizimin. Shoqëria nuk do ta ushtrojë veprimtarinë deri në çastin e paraqitjes së këtij dokumenti në organin, që ka lëshuar lejen e tregtimit ose autorizimin.

V. Hartimi i kushteve teknike

1. Kushtet teknike, që duhen respektuar në të gjitha pajisjet, impiantet, instalimet, stacionet, repartet dhe linjat teknologjike përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon veprimtarinë hidrokarbure.

2. Kushtet teknike janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha subjektet, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë në përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

3. Ministria që mbulon veprimtarinë hidrokarbure të botojë kushtet teknike.

VI.

Në rast të mosrespektimit të shkronjës "b" të pikës 6 të këtij vendimi, organi përkatës për dhënie të lejes së tregtimit apo autorizimit, ka të drejtën e heqjes së kësaj lejeje apo autorizimi për ushtrimin e veprimtarisë.

VII. Vendimet nr .129, date 18.3. 1999; nr 576, date 8.12.1999; nr .4, date 12.1.2000; nr . 719, date 21.12.2000; si dhe nr. 681, date 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

VIII. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko